



P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e rregullt e komitetit për politikë dhe financa, e mbajtur më **20.07.2022**, me fillim në ora **10:00**.
Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Defrim Kafexhiu**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes të gjithëve, të nderuar anëtarë të komitetit për politikë dhe financa, të nderuar pjesëmarrës, monitorues dhe përfaqësuesit e OSBE-së, mediave dhe të gjithë ju të pranishëm. Faleminderit shume për pjesëmarrjen, e hapim mbledhjen e 6-të të komitetit për politikë dhe financa.

Të nderuar anëtare të KPF-së për këtë mbledhje propozoj këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i raportit financiar janar – qershor 2022;
3. Shqyrtimi i raportit të punës së DKA-së për përfundimin e vitit mësimor 2021-2022;
4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Rahovecit për vitin 2021;
5. Të ndryshme;

Kryesuesi – Nëse keni diçka për të shtuar sa i përketë rendit të ditës?...Nëse jo, atëherë po vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet rendi i ditës, vazhdojmë me pikën e parë;

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; dikush diçka rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?...Me shumicë votash aprovohet procesverbali i mbledhjes së kaluar. Vazhdojmë me pikën e dytë;

2. Shqyrtimi i raportit financiar janar – qershor 2022;

Afrim Limani – I nderuar kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së, drejtoria për buxhet dhe financa me kohë ka arritur t'a përgatisë raportin 6 mujor financiar. Në këtë raport brenda kësaj periudhe janë përfshirë të gjitha ngjarjet financiare që kanë ndodhur brenda 6 muajve. Raporti ka 3 pjesë; pjesa e të hyrave, pjesa e shpenzimit të buxhetit dhe aktivitetet e zyrës së prokurimit brenda këtyre 6 muajve.

Të hyrat e rregullta për këtë 6 mujor të këtij viti janë; 598.524eu që kur e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kemi një rritje prej 49.986eu, bashkë me gjobat e gjykatave të cilat për këtë tre mujor janë; gjobat në trafik 82.000eu, gjobat e gjykatave 14.700eu në total të hyrat janë 695.359eu, nëse i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kemi rritje prej 70.026eu. Me kohë kemi arritur t'a bëjmë edhe raportin e shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë 6 mujore, në % është 48.46

apo 7.358.527eu që relativisht është përqindje (%) e mirë e shpenzimit të buxhetit brenda kësaj periudhe 6 mujore. Kemi edhe raportin analitik të pasqyruar në kategorinë mallra dhe shërbime. Nuk do të hyjë në detale, po lë vend edhe për pyetje tuaja dhe në fund i kemi edhe aktivitetet të zyrës së prokurimit të cilat janë të paraqitura në raport e që kanë ndodhur në këtë 6 mujor, e që realisht në raportin e 3 mujorshit nuk kanë qenë të përfshiera.

Rumir Zhuniqi – Faleminderit kryesues, të nderuar drejtorë, kolegë, anëtarë të KPF-së. Pyetja ndoshta nuk është direkt rreth raportit, por e pashë që buxheti është diku rreth 50% shpenzimi i buxhetit për 6 mujorin e parë, në disa kategori si në paga, subvencione etj.. shpenzimi i buxhetit bëhet më lehtë sepse është i planifikuar, mirëpo te investimet kapitale, a mund të shpenzohet buxheti komplet këtë vit ose afërsisht, duke e patur parasysh që një numër i madh i operatorëve nuk punojnë për shkak të ndryshimeve të çmimeve, a paraqet rrezik kjo që buxheti për këtë vit për investime kapitale të mos shpenzohet në nivelin se si është shpenzuar viteve tjera?...

Afrim Limani – Faleminderit Rumir për pyetjen, konsideroj që e keni bërë një pyetje me vend dhe të qëlluar, shumë e vertetë është që rrezikohemi në këtë pikë përshkak të mosfillimit ose mosmbarimit të punimeve, mirëpo të them të drejtën në pjesë e madhe të investimeve kapitale i kemi obligime të cilat i kemi bartur dhe aktualisht shumë operatorë kanë filluar punën në terren. Nuk bënë t'a thejmë traditën po shpresojmë që deri në fund të vitit kemi me arrite që buxhetin t'a shpenzojmë 99%... E dijmë që vitin e kaluar buxheti është shpenzuar 99% dhe është një shembull që rrallë në komunat e tjera shpenzohet në këtë përqindje.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, nëse nuk ka dikush diçka në lidhje me këtë pikë, atëherë pika e dytë nuk ka nevojë të votohet, kalon tutje, e ftoj drejtorin e DKA-së t'a prezantoj pikën e tretë;

3. Shqyrtimi i raportit të punës së DKA-së për përfundimin e vitit mësimor 2021-2022;

Avni Morina – I nderuar kryesues, anëtarë të KPF-së, drejtorë të drejtorive. Në këtë raport janë pasqyruar të gjitha aktivitetet, punët dhe angazhimet e drejtorisë komunale për arsim nga një shtatori i vitit 2021 deri në fund të muajit qershor 2022. Këtë raport e kemi ndarë në dy periudha; Periudha shtator – dhjetor 2021 dhe janar – qershor 2022. Raportin iu kemi dërguar edhe në email nga sekretaria e kuvendit, në qoftëse e shihni të nevojshëm mund edhe t'a lexoj, janë 4 faqe material me kryesisht pasqyrimin e të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me drejtorinë e arsimit që nga fillimi i vitit mësimor deri në fund, kuptohet që viti mësimor ka kohë deri më 31 gusht, ku janë paraparë edhe disa aktivitete të DKA-së, meqenëse sipas planit të punës së kuvendit është paraparë ky raport, ne jemi përgatitur për këtë. Në qoftëse keni ndonjë sygjërim, vërejtje, paqartësi.. pres nga ju angazhim rreth këtij raporti.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, dikush diçka rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po kalojmë te pika e katërt e rendit të ditës;

4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Rahovecit për vitin 2021;

Afrim Limani – Me dëshirë këtë hapësirë e kisha lënë për juve për pyetje, por e kam obligim t'i them disa fjalë më kryesore rreth raportit të auditimit të pasqyrave financiare për komunën e Rahovecit 2021. Raporti ka dalë i kualifikuar që i bjen në zërtim jo i mirë, me 4 rekomandime i bie që neve na është bërë e padrejtë që kemi ra viktimë e disa reformave të ndërmarra nga strukturat në zyrën kombëtare të auditorit. Jo vetëm ne, por edhe shumë komuna të Kosovës kanë dalë me një raport të tillë të kualifikuar. Po e them me plotë bindje që neve n'a është bërë e padrejtë sepse kemi fakte dhe dëshmi të prezantuara të cilat nuk i kanë marrë parasysh. Nëse analizojmë mirë rregulloren financiare


02/2013 si dhe listën e projekteve kapitale, neve n'a është bërë e padrejtë të opinionit i kualifikuar. Po e lë hapësirën për ndonjë pyetje dhe shumë kam qejf të ma bëni ndonjë rreth këtij raporti.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, a ka ndokush ndonjë pyetje?...Nëse jo, atëherë po kalojmë te pika e fundit e rendit të ditës;

5.Të ndryshme; Nëse dikush prej anëtarëve të KPF-së ka ndonjë çështje për diskutim, e ka hapësirën tani.. Nëse jo, atëherë po e mbyllim mbledhjen dhe shihemi në seancën e rregullt.

Mbledhja përfundoj në 10:20

Procesmbajtësi



Agim Hoti

